

10.03.2021
Ora 11:17

RENDI I DITËS

Projektakti “Për kthimin për korrigjim të dokumentacionit të listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet të depozituar nga Partia Lëvizja e Re për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja**

• **Parti Politike: PLR, PAD, PLN, PLDSH**

Z.I.Celibashi: Mirëdita të gjithëve, atëherë në seancën publike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për sot kemi këto çështje të rendit të ditës: Projektvendimin “Për kthimin për korrigjim të dokumentacionit të listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet të depozituar nga Partia Lëvizja e Re për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”. Projektvendimin “Për kthimin për korrigjim të dokumentacionit të listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet të depozituar nga Partia Aleanca Demokracia e Re”, Projektvendimin “Për kthimin për korrigjim të dokumentacionit të listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet të depozituar nga Partia Aleanca Lëvizja për Ndryshim”, Projektvendimin “Për kthimin për korrigjim të dokumentacionit të listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet të depozituar nga Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare”. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës i japim fjalën Sekretarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të relatuar projektaktin.

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

Z. Y. Merkaj: Partia Lëvizja e Re është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Në bazë të neneve 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor, Partia Lëvizja e Re ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore në bazë të nenit 78 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listën shumemërore të kandidatëve për deputet të Partisë Lëvizja e Re dhe dokumentacionin bashkëlidhur duke konstatuar mangësi në mos përmbushjen e dokumentacionit si më poshtë disa qarqe Qarkut Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë, Kukës Dibër dhe Shkodër kanë tejkalluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë në listën shumemërore dhe nuk përputhen me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu për Qarkun Durrës, Elbasan Fier, Gjirokastrë, Korçë, Tiranë dhe Vlorë rezultojnë se formulari i vetëdeklarimit të kandidatëve për deputet të paplotësuar. Në këto kushte i propozoj Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të kthejë dokumentacionin për të korrigjuar, faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit zoti sekretar, kemi dhe përfaqësuesin e këtij subjekti politik. Në lidhje me këtë projektakt, keni ndonjë gjë?

Përfaqësuesi i PLR-së: Jam dakord vetëm sa afat kemi dhe nëse janë të detajuara, cilat janë emrat e personave që mungojnë në dokumentacion. Sa afat kemi?

Z. Y. Merkaj: 48 orë.

Përfaqësuesi i PLR-së: Në rregull.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

Z.I.Celibashi: Meqenëse nuk kemi diskutime të tjera në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës bazuar në nenin 19 pika 1.

Znj.E.Bushati, përfaqësuese e Partisë LN: Unë përfaqësoj një subjekt tjetër por mendoj duke parë rendin e ditës që ju me të drejtë na keni njoftuar dhe projektvendimet besoj janë në të njejtën linjë dhe me atë që kemi parë edhe nga një postim i juaji besoj që ka nevojë për të diskutuar mbi mënyrën sesi interpretohet neni 67 me numrin në listë të kandidatëve, se besoj se kjo është e përgjithshme për të katër subjektet që është njoftimi për të cilin ju na keni ftuar sot.

Z.I.Celibashi: Meqenëse logjikisht argumenti qendron për të gjitha rastet edhe pse ju si palë nuk keni interes të drejtpërdrejt në lidhje me atë subjekt mund ta bëni diskutimin dhe unë jua jap fjalën dhe vazhdojmë duke e konsideruar si diskutim parimor.

Z. D. Prenga, përfaqësues i Partisë LN-së: Faleminderit zoti Komisioner, në lidhje me këtë çështje edhe pse natyra e aktit është konkret secili nga katër aktet do të prodhojë pasojë të drejtpërdrejtë për subjektin që i adresohet. Në anën përmbajtësore shfaqet në trajtën e një norme le ta quajmë kështu për një praktikë. Prandaj kërkuam dhe fjalën në këtë fazë, në mënyrë që të mos konsumojmë kohë të tepërt në një etapë të dytë. Përcaktimet e nenit 67 nuk isha shumë i qartë në mënyrën si ka arsyetuar administrata e KQZ-së për të vlerësuar preorgativën e përcaktuar saktësisht në këtë formë siç po e lexoj numrin e kandidatëve në listën shumemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i kandidatëve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatës shtuar dy dhe pastaj të pjestohet me tre. Në këtë kuptim dhënia e një numri mbi dy më shumë sesa numri i mandateve nuk përbën

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

shkak të përligjur për të bërë korrigjime dhe rishikime të listës, por besoj në një kohë të dytë KQZ-ja mund të vendosë sesi do të paraqitet kjo punë në fletën e votimit, sepse një fletë votimi një numër “lajthitës” në kuptimin e orientimit të zgjedhësit natyrisht se nuk është e mirëpritur për askënd dhe nuk plotëson funksionin por në këtë fazë diskutimi mendoj dhe kjo do të jetë në qoftë se do të jetë dhe rasti ynë pastaj do ta marr fjalën për fjalën konkret se mund të mos jetë ky besoj që nuk është një shkak i drejtpërdrejtë për ta kthyer në qoftë se elementet e tjerë i përmban dispozitave dhe kërkesave ligjore në lidhje me këtë aspekt. Në këndvështrimin tim dhe ndoshta po dal pak jashtë kontekstit duke më lejuar si ish anëtar i KQZ-së ndoshta mund ta them këtë do të kishte qenë e mirëpritur sikur menjëherë pasi ka kaluar afati ligjor që është i interpretuar nga KQZ-ja përkatësisht në një bonus tjetër 48 orësh. Subjektet kanë pasur të gjithë kohën e mjaftueshme për të bërë qartësisht plotësimin në kushte ligjore për listat dhe ato lista mund të ishin publikuar që të gjithë ta dinë bëhet fjalë për të konkuruar për anëtarë të Kuvendit, kështu që nuk ka asgjë për të fshehur aty mund të kishin dalë dhe kjo do ta bënte më transparente në këndvështrimin tim por sa i takon pjesës që diskutova i mbahem dhe në kuadrin e një propozimi që të shihet kjo mundësi. Listat të mos kthehen për këtë shkak pasi KQZ-ja vetë në një etapë të dytë, në qoftë se ka kaluar numëri thotë “unë në fletën e votimit unë kaq mund të paraqes”, mund të krijojë një problem për barazinë e kandidatëve në të drejtën e tyre pasive për t’u zgjedhur, por kjo është një çështje interpretimi në një etapë të dytë besoj. Në pikëpamjen time kaq doja në këtë fazë të diskutimit, faleminderit!

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e Partisë LN: Më shumë në karakterin juridik, ne e pamë me hollësi nenin 67 ku në pikën 4 lihet e padiskutueshme që numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i


*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse shtuar dy. Pra, për çdo qark do të ketë një plus dy kjo është e qartë e thënë në ligj se si interpretohet në çdo rast numri i kandidatëve të listës duhet të jetë i plotëpjestueshëm me numrin 3 pastaj këtu fillon diskutimi. Së pari do të kishte qenë e udhës që KQZ, Komisioneri ta përcaktonte më përpara afatit maksimal të dorëzimit të listave mënyrën sesi e ka interpretuar këtë pikë të nenit 67 të ligjit. Fakti që sot po interpretohet pasi kanë kaluar dy ditë nga afati maksimal i dorëzimit të listave duke i dhënë në një farë mënyre dhe afat prapaveprues këtij vendimi që në dukje është si akt individual po në fakt do të ketë efekt dhe për zgjedhje të tjera kur të vinë. Kjo aq më tepër duke shtuar që sot janë thirrur vetëm katër subjekte zgjedhore kur ne dimë nga media që të paktën Partia Socialiste dhe Partia Demokratike nuk e ka respektuar këtë dhe ne nuk i shohim sot në këtë mbledhje. Mendoj që kjo cënon rregullat e lojës dhe barazinë që duhet të ketë çdo subjekt para ligjit në interpretimin e tij aq më tepër shtojmë këtu që kjo jep kohën e nevojshme. Kohën që ju duhet në fakt subjekteve të mëdha zgjedhore për të ndryshuar renditjen ku siç jemi të njohur dhe me fakte nga media ato akoma nuk kanë zënë vend nuk kanë dorëzuar jo vetëm listën sipas interpretimit të nenit 67, por nuk kanë dorëzuar as dokumentacionin përkatës shoqërues për listën. Kjo në fakt, ne ndihemi dhe të cënuar pak në emrin e mirë se si parti e krijuar rishtas kemi ardhur e kemi depozituar që në orën 09:00 të mëngjesit të gjithë dokumentacionin për çdo qark. Të metat që ka nxjerrë KQZ-ja janë thjesht numri tek lista e kandidatëve me efekt prapaveprues siç thashë më përpara dhe dy ose tre formularë për t'u plotësuar ndërkohë që dy subjektet e tjera apo tre subjektet e tjera PS, PD, LSI kanë një mal me probleme në listën e tyre kjo na cënon ne dhe përballë publikut duke na cënuar edhe të drejtën tonë për të garuar të barabartë, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

Z.I.Celibashi: Sikurse ju shumë mirë mund ta dini procesi i verifikimit të dokumentacionit të kandidimit për çdo subjekt zgjedhor është një proces i cili kërkon qoftë edhe kohën e vet fizike nga institucioni i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Qoftë edhe në përputhje me radhën e paraqitjes së këtij dokumentacioni, KQZ ka shqyrtuar dhe ka vlerësuar në radhë të parë dokumentacionin e atyre subjekteve të cilat e kanë sjellë dokumentacionin dhe kandidimin që në orën 09:00 të mëngjesit dhe pastaj me subjektet e tjera. Fakti që në rendin e ditës së mbledhjes së sotme janë vetëm katër subjekte nuk përjashton që edhe për subjektet e tjera nëse gjatë procesit të verifikimit do të rezultojë se ka probleme me dokumentacionin nuk do të ketë shqyrtim dhe seancë publike. Prosesi i vlerësimit të këtij dokumentacioni është duke bërë dhe për subjektet e tjera deri në këtë moment që ne flasim pra kur kemi thirrur këtë mbledhje ose deri momenti kur vendosim të thërrasim këtë mbledhje përfundoi shqyrtimi i parë paraprak i dokumentacionit të kandidimit për këto subjekte. E rikthesoj dhe rikonfirmoj dhe një herë jemi duke bërë vlerëimin paraprak të dokumentacionit edhe të subjekteve të tjera dhe në rast se do të verifikohet që dhe për subjektet e tjera kushdo qofshin këta Partia Socialiste, Partia Demokratike, Lëvizja Socialiste për Integrim apo dhe parti të tjera do të ketë shqyrtim publik dhe seancë publike edhe për rastin e tyre. Kjo për sa i përket këtij shqetësimi të parë po të listuar i fundit nga ana juaj. Përsa i përket thelbit të çështjes Komisioni Qendror i Zgjedhjeve veçanërisht në mënyrë të posaçme Komisioni Rregullator nxjerr akte nënligjore për ato raste të cilat Kodi Zgjedhor i ka përcaktuar që do të duhet të nxjerrë akte normative ose akte nënligjore në bazë dhe për zbatim të Kodit Zgjedhor. Në ato raste për të cilat Kodi nuk e kërkon në mënyrë literale drejt për së drejti ose dhe nga interpretimi qoftë integral i gjithë Kodit Zgjedhor nuk rezulton që ka nevojë për të dalë një akt normativ. Nuk ka asnjë arsye pse Komisioni

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

Qendror i Zgjedhjeve dhe në mënyrë të posaçme Komisioni Rregullator të nxjerrë akte nënligjore. Rasti të cilin ne po diskutojmë e kemi sjellë në diskutim ka të bëjë me një diskutim të drejtpërdrejtë të një norme e cila në vlerësimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve por mesa duket edhe të Komisionit Rregullator nuk ka nevojë për të nxjerrë një udhëzim një vendim të karakterit normativ apo dhe të karakterit shpjegues dhe sqarues. Në vlerësimin e Komisionerit Shtetëror është e qartë sesi në çfarë mënyre forme dhe afati subjektet politike të regjistruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve do të duhet t'i depozitojmë dhe duhet t'i prezantojmë dokumentet e kandidimit. Për të lehtësuar procesin Komisioneri Shtetëror ka bërë një sqarim publik të asaj sesi ai e kupton këtë normë e cila në kuptim të rastit është e njëjta gjë sikur ta bënte dhe të pyesë kur fillon orari i votimit është kaq e qartë për Komisionerin Shtetëror kuptimi i ligjit dhe në këtë rast sikurse është kuptimi i ligjit se kur është orari i votimit. Bazuar mbi këtë kuptim të plotë të qartë të ligjit jemi duke bërë shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të kandidimit të paraqitur nga subjektet politike të ndryshme partitë politike dhe koalicion, koalicionet e partive politike. Në vlerësimin e Komisionerit Shtetëror numri i kandidatëve në listën shumëmemërore për cdo parti politike dhe koalicion sipas vlerësimit tim në interpretim të pikës 4 të nenit 67 do të thotë që numrit të mandateve për çdo qark duhet t'i shtohen dy kandidatë të tjerë në listë, por në çdo rast shumatori do të jetë i plotëpjestueshme. Ky numër duhet të jetë i plotëpjestueshëm me tre do të thotë që në rastin kur ti i shton dy nuk përpjestohet me tre atëherë do ta bësh të plotëpjestueshëm me tre, sepse ky është rregulli i përcaktuar nga kodi. Shtesa me dy është përjashtim për mendimin tim atëherë do t'i shtosh jo dy por një për të bërë plotëpjestimin. Pa dyshim që në kuptimin literal mundet të ishte shkruar më mirë kjo si normë, por nuk jemi këtu për të bërë kritikën e ligjbërësit, por për një interpretim logjik. Ka dhe interpretim

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

logjik të normës. Numri i kandidatëve në listën shumemërore nëse do të marrim në referim argumentin e zotit Prenga mund të ishte dhe pa sens në një lloj mënyre sepse askush nuk e pengon. Kush është dallimi ndërmjet njëshit dhe dyshit? Dallimi është ndërmjet zeros dhe njëshit, por ndërmjet 1-shit dhe 2-shit nuk ka dallim. Kështu që askush nuk mund të thotë që shiko më takon që të sjell sipas Kodit Zgjedhor 39, apo 42, apo 120, apo 1200. Kështu që në këtë kuptim mendoj se është shumë e qartë që numri minimal i kandidatëve në listën shumemërore për çdo qark, për çdo parti politike nuk mund të jetë më pak se numri i mandateve në atë qark shtuar dy. Pra, ky është maksimumi, por në çdo rast do të bëhet plotpjestimi me tre dhe atje ku nuk përpjestohet me tre pasi i shtohen dy do t'i shtosh vetëm një, faleminderit! Po zoti Prenga!

Z. D. Prenga, përfaqësues i Partisë LN-së: Për ta përmbyllur dhe jo për të shpenzuar kohën, sepse jemi të gjithë të ndërgjegjshëm për ngarkesën që keni. Ajo çfarë doja të them se mënyra si është ndërtuar dispozita nuk është një çështje matematike, ajo mund të interpretohet plotësisht dakord me krahasimin që bëtë, por në anën e strukturës legjislative të kësaj dispozite nuk lihet vend për kthim, për plotësim dhe për rregullim. Në çastin kur fleta e votimit do të bëhet, në atë moment KQZ-ja thotë “këto që keni sjellë më shumë se e çmojmë ne, shumë mirë janë kandidatura por, nuk kanë arsye të jenë dhe të na bëjnë fletën e votimit një libër të madh. Kurse shqetësimi ynë që të jemi transparent dhe për mënyrën se si na u dha dhe mundësia për të folur dhe për këtë fazë diskutimi j’u falenderojmë. Pasi të kuptojmë, nga natyra akti është konkret dhe shumë mirë fjala e parë do të ishte a legjitimohen për këtë çështje? Ajo çfarë na shqetëson nuk ka të bëjë me veprimin e KQZ-së në këtë fazë, në rastin tonë, por kthimi për rregullim mund të zgjerohet rrugës nga subjektet për të bërë riplotësime shtime. Ajo çfarë mund të

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

bëjmë në këtë fazë është vetëm të heqim në kuptimin e saktë listave të ngurtësuar ditën që është paraqitur në KQZ. Ajo listë ka marrë trajtën e një akti dhe si e tillë është i pandryshueshëm përpos kur KQZ-ja me autoritetin që i jep ligji ndërhyr sipas preogativave dhe që u diskutua. Por, në një fazë të dytë nuk është se nuk ka ndodhur oreksi i subjekteve do të jetë dhe për të bërë rishikime të tjera fundamentale që çënojnë integritetin e procesit dhe zonja Bushati e tha, e qartësoi. Unë thjesht po e rikapituloj, por meqenëse e kisha marrë fjalën në fillim dhe në fund të fundit jemi të interesuar për një akt funksional një praktikë që në vijim edhe pse akt konkret do të krijojë marrëdhënien të ligjshme dhe të drejta mes subjekteve, por njëkohësisht edhe pa çënuar integritetin e pjesës të cilës po diskutojmë. Në çmimin tim por edhe në kuadrin e cilësisë së përfaqësuesit të një subjekti, ne mendojmë që akti mund t'i hapë rrugë një procesi të kësaj natyre që për mua pastaj është në vijën e paligjshmërisë. Subjektet mund të vijojnë me ndryshime, me ndryshime, inovacione duke shtuar emra, duke shtuar mbiemra duke ndryshuar renditjet dhe gjëra që në fakt bien haptas ndeshur me përcaktime ligjore që po i referohemi. Faleminderit për këtë mundësi për ta shprehur në mënyrë të plotë mendimin që kishim për këtë çështje.

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Në referim të asaj se çfarë ju thatë, Kodi Zgjedhor ka përcaktuar detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të bërë vlerësimin e dokumenteve të kandidimit të paraqitur nga partitë politike dhe nuk ka bërë një listë të vlerësimit për të cilat dokumente do të bëjë vlerësimin dhe do të kërkoj plotësim Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe për të cilat jo. Pra në mënyrë integrale i gjithë seti i dokumentacionit që depozitohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve gjatë aplikimit është objekti i shqyrtimit nga KQZ. Kërkohej që paraqitja e këtij dokumentacioni të jetë tërësisht në përputhje me parashikimet e

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

ligjit sikur qoftë edhe një element i këtyre parashikimeve të ligjit në vlerësim të KQZ-së nuk plotësohet, KQZ ka të drejtën që t'ia kthejë për plotësim subjektit. E dyta, ajo çfarë ju thatë me të drejtë po, qendron, është shqetësimi që partitë politike gjatë këtij momenti mund të bëjnë ndryshime të listave të tjera, unë mendoj dhe vlerësoj që kjo mund të ndodhë dhe është e lejshme të ndodhë. Kodi ka përcaktuar që të themi radhitja në listën shumemërore nuk ndryshon në momentin që miratohet në nuk e kemi miratuar akoma deri në momentin e miratimit të listës partitë politike dhe koalicionet qoftë në përputhje me urdhërimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve pasi ka bërë vlerësimin paraprak të dokumentacionit por unë mendoj edhe me iniciativë është në të drejtën e tyre që të rikonsiderojmë qoftë në pikëpamje të sasisë qoftë edhe në pikëpamje përmbajtësore në dokumentet e kandidimit. Për ta kuptuar sipas meje më thjesht po ju jap një shembull të themi se e ka sjellë një parti politike listën të paktën në përbërje të numrit aq sa e ka përcaktuar Kodi Zgjedhor. Pra të themi për bashkinë për Qarkun e Tiranës një subjekt politik ka sjellë numrin 36 që është numri që sipas Kodit Zgjedhor duhet të jetë ai i kandidatëve në listën shumemërore. Nëse për një arsye të përligjur njëri prej kandidatëve në këtë listë do të japë dorëheqjen brenda afatit jo më vonë se 45 ditë përpara datës së zgjedhjeve unë vlerësoj që kjo mund të ndodhë x që është në atë listë si kandidat për deputet jep dorëheqjen dhe partia ka të drejtën e zëvendësimit. Ky është interpretimi që KQZ i bën edhe bazuar mbi këtë interpretim do të jetë edhe ecuria e vendimmarrjes për raste të tilla. Faleminderit! Mendoj se mjaftueshëm diskutuam për këtë çështje. E mbyllim diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës dhe kalojmë në vendim. Bazuar në nenin 19 pika 1, shkronja "n" dhe 2 neni 67, 72 dhe 73 pika 1 të Kodit Zgjedhor të Shqipërisë si dhe Udhëzimi nr.1 datë 23.12.2020 për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit të

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

vendos: Kthimin për korigjim të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet të Partisë Lëvizja e Re për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill të vitit 2021.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sankisoneve.

Faleminderit!

Vendimi nr.123

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.02.2021*

**10.02.2021
Ora 11:43**

RENDI I DITËS

Projektakti “Për kthimin për korrigjim të dokumentacionit të listës shumemërore të kandidatëve për deputet të depozituar nga Partia Aleanca Demokracia e Re për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, A.Tenolli**
- **Parti Politike:** **PLR, PAD, PLN, PLDSH**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Po Partia Aleanca Demokracia e Re është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Në bazë të nenit 67 dhe 70 të Kodit Zgjedhor ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore. Në bazë të nenit 73 të Kodit Zgjedhor Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka verifikuar listat shumemërore ku ka konstatuar mangësi të dokumentacionit si më poshtë. Kërkesa për regjistrim të listës shumemërore të kandidatëve për deputet në zonën zgjedhore të Qarkut Tiranë, Vlorë, Dibër, Elbasan, Korçë, Kukës, Shkodër dhe Durrës nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor duke tejkalluar numrin e kërkuar në listën shumemërore. Gjithashtu në formularin e deklaramit për kandidatin për deputet me numër 14 të listës shumemërore Qarku Tiranë mungon

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.02.2021*

emri mbiemri dhe nënshkrimi i kandidatit. Në këto kushte administrata propozon kthimin për plotësim dokumentacioni dhe korigjimin e mangësimit të konstatuara nga subjekti zgjedhor Partia Aleanca Demokracia e Re. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësues nga kjo parti? Po fjala është për ju.

Z. Përfaqësuesi i Partisë Aleanca Demokracia e Re: Përshëndetje jemi dakord dokumentacioni siç e mora vesh dhe nga zotëria duhet të sillet i korigjuar brenda 48 orësh.

Z. I. Celibashi: Diskutime të tjera? Nuk kemi. Bazuar në nenin 19 pika 1 shkronja “n” dhe 2 neni 67, 72 dhe 73 pika 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe Udhëzimi nr.1 datë 23.12.2020 “Për caktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit vendos:

1.Kthimin për korigjim të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputetë të Partisë Aleanca Demokracia e Re për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve. Faleminderit!

Vendimi nr.124

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



10.03.2021
Ora 11:46

RENDI I DITËS

Projektakti “Për kthimin për korigjim të dokumentacionit të listës shumemërore të kandidatëve për deputet të depozituar nga Partia Lëvizja për Ndryshim për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:** **PLR, PAD, PLN, PLDSH**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Po Partia Lëvizja për Ndryshim është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Në bazë të nenit 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore. Referuar nenit 72 të Kodit Zgjedhor është bërë verifikimi i listave shumemërore ku është konstatuar mangësi të dokumentacionit si më poshtë. Kërkesa për regjistrim të listës shumemërore të kandidatëve për deputet në zonën zgjedhore të Qarkut Tiranë, Vlorë, Dibër, Elbasan, Korçë, Kukës Shkodër dhe Durrës nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor duke tejkaluar numrin e kërkuar në listën shumemërore. Gjithashtu në formularin e vetëdeklarimit kandidati për deputet me numër rendor 8 në Qarkun Fier rezulton e paplotësuar rubrika numër 3 e formularit të

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021**

vetëdeklarimit. Gjithashtu me numër rendor 1 Qarku Gjirokastrë rezulton e paplotësuar rubrika numër 3 në formularin e vetëdeklarimit të numrit rendor 1. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit kthimin për plotësim dokumentacioni dhe korigjimin e mangësive të konstatuara nga kjo parti. Bashkëlidhur kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit zoti Sekretar, përfaqësuesit e Partisë Lëvizja për Ndryshim?

Z.D.Prenga, përfaqësues i Partisë LN: Ne diskutuam në parim dhe nuk ka pse të flasim për jdo rast, pasi në këndveshtrimin tonë është një praktikë që po sanksionohet. Edhe pse kishim objeksionet tona vendimi i Komisionerit është i ankimeshëm dhe jo i diskutueshëm. Nëse e çmojmë që janë çenuar interesat tona për integritetin e zgjedhjeve natyrisht që do ushtrojmë të drejtën tonë ligjore. Por për thelbin ne i kemi thënë të gjitha dhe përsëri gjej rastin t’Ju falenderoj për mundësinë që më dhatë për ta shtjelluar plotësisht këtë çështje.

Z.I.Celibashi: Po faleminderit zoti Prenga. Diskutime të tjera? Nuk kemi! Bazuar në nenin 19 pika 1 shkronja “n” dhe 2 neni 67, 72 dhe 73 pika 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe Udhëzimi nr.1 datë 23.12.2020 “Për caktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, vendos:

1.Kthimin për korigjim të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputetë të Partisë Lëvizja për Ndryshim për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve. Faleminderit!

Vendimi nr.125

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



10.03.2021
Ora 11:49

RENDI I DITËS

Projektakti “Për kthimin për korrigjim të dokumentacionit të listës shumemërore të kandidatëve për deputet të depozituar nga Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:**
 - PLR, PAD, PLN, PLDSH**

Z.I.Celibashi: Meqenëse nuk kemi çështje të tjera në rendin e ditës.

Z.Y.Merkaj: Zoti Komisioner kemi dhe Lëvizjen Demokratike Shqiptare, pika nr.4. Është pika e fundit.

Z.I.Celibashi: Po, në rregull.

Z.Y.Merkaj: Edhe Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare ka të njëjtën problematikë, ka depozituar listat shumemërore. Nga verifikimi është konstatuar mangësi në paraqitjen e dokumentacionit. Kërkesa për listën shumemërore të kandidateve për deputet në zonën zgjedhore Qarku Kukës nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu në formularin e vetëdeklarimit për numërin rendor 12 të listës shumemërore Qarku Elbasan

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021**

rezulton e paplotësuar. Në formularin e vetdeklarimit të kandidatit për deputet të numrit rendor 4 dhe 7 të Qarkut Korçë, numri rendor 5 Qarkut Korçë dhe 10 rubrika numër 2 rezulton e paplotësuar me emër dhe mbiemër. Në këto kushte propozojmë Komisionerit kthimin për plotësim dokumentacioni dhe korrigjimin e mangësimeve të konstatuara. Bashkëlidhur kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit zoti Sekretar, përfaqësuesi i Partisë Lëvizja Demokratike Shqiptare?

Z.Përf i PLDSH: Dakord, do t'i dergojmë brenda afatit ligjor dokumentat e plotësuar.

Z.I.Celibashi: Faleminderit, atëherë mëqenëse nuk kemi diskutime të tjera për këtë pikë të rendit të ditës . Bazuar në nenin 19 pika 1 shkronja “n” dhe 2 neni 67, 72 dhe 73 pika 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe Udhëzimi nr.1 datë 23.12.2020 “Për caktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit” vendos:

- 1.Kthimin për korigjim të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputetë të Partisë Lëvizja Demokratike Shqiptare për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

Kjo ishte pika e fundit e rendit të ditës, besoj. Meqenëse nuk kemi çështje tjetër për të shqyrtuar në rendin e ditës mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit, përfaqësuesit e partive politike për kontributet e tyre, faleminderit edhe përfaqësuesesve të administrates, ditë të mbarë!

Vendimi nr.126

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

**10.03.2021
Ora 18:19**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Mbi verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të kandidimit të subjektit zgjedhor Partia Nisma Thurje për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Z.Y.Merkaj, O.Peto, M.Koja, E.Allushi

• **Parti Politike: Koalicioni ABEOK, BK, PSD, PD, PS, PBD**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me shqyrtimin e dokumentacionit të listës shumemërore të kandidatëve për deputet të depozituar nga Partia Nisma Thurje.

Z. Y. Merkaj: Partia Nisma Thurje është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Në bazë të nenit 67 dhe 71 të Kodit Zgjedhor ka paraqitur kërkesën pranë KQZ-së për miratimin e listave shumemërore. Referuar nenit 73 të Kodit Zgjedhor KQZ ka verifikuar listën shumemërore të kandidatëve për deputet të paraqitur nga Partia Nisma Thurje dhe ka konstatuar mangësi në dokumentacion si më poshtë:

Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore për kandidatin për deputet për zonën zgjedhore Qarku Dibër nuk është në përputhje me artikullin 6 pika 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu formulari i kandidatit me nr.rendor 8 të Qarkut Dibër, rezulton i paplotësuar. Në formularin për deklaram të kandidatit me nr.4 të Qarkut

**Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

Fier rezulton në rubrikën “a” nuk është shënuar nr. ID. Parregullsi të tjera ka dhe në Qarkun Fier për kandidatin me nr.8, Qarkun Elbasan për kandidatin me nr.3 dhe nr.16. Gjithashtu Qarku Korçë, Kukës dhe Shkodër nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 pasi është tejkualuar numri i kërkuar i kandidatëve për deputet gjithashtu dhe për Qarkun Tiranë nr.12 dhe 35 rezultojnë rubrikat të pa plotësuara në formularin e deklaramit. E njejta problematikë është dhe në Qarkun e Vlorës pasi është tejkualuar numri i kandidatëve për deputet gjithashtu dhe nr.6 për listën shumëmemërore Qarku Vlorë rezulton e pa plotësuar një rubrikë pasi nuk ka vendosur nr. e ID. Në këto kushte i kërkoj KQZ-së të kthejë për plotësim dokumentacionin e kandidimit për regjistrimin e mangësive të konstatuara nga subjekti politik Partia Nisma Thurje. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, falemindert!

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit. I jap fjalën përfaqësuesit të Partisë Nisma Thurje zotit Laska.

Z. N. Laska, përfaqësues Partia Nisma Thurje: Faleminderit, parimisht jam dakord.

Z. I. Celibashi: Atëhere, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe 2, neni 67, 72 dhe 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe Udhëzimi nr.1 datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, vendos:

- 1.Kthimin për korrigjim sipas gjetjeve të renditura në këtë akt, këtë dokumentacion të listës shumëmemërore të kandidatëve për deputetë të Partisë Nisma Thurje për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
- 2.Dokumentacioni të dorëzohet brenda datës 16.03.2021;

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

- 3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e KQZ-së;
- 4.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, faleminderit.

Vendimi nr.127

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino*



10.03.2021
Ora 18:23

RENDI I DITËS

Projektvendim “Mbi verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të kandidimit të subjektit zgjedhor Partia Balli Kombëtar për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Z.Y.Merkaj, O.Peto, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike: Koalicioni ABEOK, BK, PSD, PD, PS, PBD**


Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me shqyrtimin e dokumentacionit të listës shumemërore të kandidatëve për deputet të depozituar nga Partia Balli Kombëtar.

Z. Y. Merkaj: Partia Balli Kombëtar është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Në bazë të nenit 67 dhe 71 të Kodit Zgjedhor ka paraqitur kërkesën pranë KQZ-së për miratimin e listave shumemërore. Referuar nenit 73 të Kodit Zgjedhor KQZ ka verifikuar listën shumemërore të kandidatëve për deputet të paraqitur nga Partia Balli Kombëtar dhe ka konstatuar mangësi në dokumentacion si më poshtë :

Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore për kandidatin për deputet për zonën zgjedhore Qarku Tiranë ka tejkalar numërin e kërkuar në listë dhe nuk është në përputhje me kriterin gjinor. Gjithashtu kërkesa për listën shumemërore Qarku Elbasan nuk është në përputhje me pikën 4 pasi është tejkalar numëri i kërkuar i kandidatëve. Gjithashtu është tejkalar dhe numëri për Qarkun Gjirokastër, Durrës

Zbardhi materialin e inçizuar

Silvi Sino



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

dhe Korçë ku përveç tejkalimit të numërit të kandidatëve është dhe kriteri gjinor. Ka dhe tek deklaratimet për deputetë të Qarkut Durrës nr.3, pika 7 e formularit rezulton e paplotësuar, nr.7, pika 8 rezulton e paplotësuar. Formulari me nr.6, pika 8 rezulton e paplotësuar e njëjta problematikë dhe për nr.9, Qarku Korçë, pika 7 rezulton e paplotësuar. Lista shumëmemërore për Qarkun e Vlorës ka tejkeluar numërin e kërkuar të kandidatëve. Në formularin e deklaratimit nr.6, Qarku Vlorë, pika 5 rezulton e paplotësuar, po në Qarkun Vlorë nr.10, pika 8 rezulton e paplotësuar. Për kandidatin nr.10 të listës shumëmemërore formulari deklaratimit Qarku Vlorë rezulton e paplotësuar pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6. E njëjta problematikë për Qarkun Berat, Fier, Lezhë dhe Dibër. Në këto kushte i kërkoj KQZ-së të kthejë për plotësim dokumentacionin e kandidimit për regjistrimin e mangësive të konstatuara nga subjekti politik Partia Balli Kombëtar. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit. I jap fjalën përfaqësuesit të Partisë Balli Kombëtar zotit Alimadhi.

Z. E. Alimadhi, përfaqësues i Partisë Balli Kombëtar: Faleminderit, jam dakord me gjetjet, do t'i plotësojmë brenda afatit ligjor dhe ata kandidatë që janë tepër do t'i heqim e të plotësojmë pikën që plotpjesëtohen me 3, jam dakord.

Z. I. Celibashi: Atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe 2, neni 67, 72 dhe 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe Udhëzimi nr 1 datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, vendos:

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

- 1.Kthimin për korrigjim sipas gjetjeve të renditura në këtë akt, këtë dokumentacion të listës shumëmeore të kandidatëve për deputet të Partisë Balli Kombëtar për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
- 2.Dokumentacioni të dorëzohet brenda datës 16.03.2021;
- 3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e KQZ-së;
- 4.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, faleminderit.

Vendimi nr.128

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

**10.03.2021
Ora 18:27**

RENDI I DITËS

Projektvendim "Mbi verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të kandidimit të subjektit zgjedhor Partia Bindja Demokratike për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021".

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: Z.Y.Merkaj, O.Peto, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike: Koalicioni ABEOK, BK, PSD, PD, PS, PBD**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me shqyrtimin e dokumentacionit të listës shumemërore të kandidatëve për deputetë të depozituar nga Partia Bindja Demokratike.

Z. Y. Merkaj: Partia Bindja Demokratike është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Në bazë të nenit 67 dhe 71 të Kodit Zgjedhor ka paraqitur kërkesën pranë KQZ-së për miratimin e listave shumemërore. Referuar nenit 73 të Kodit Zgjedhor KQZ ka verifikuar listën shumemërore të kandidatëve për deputetë të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike dhe ka konstatuar mangësi në dokumentacion si më poshtë:

Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore për kandidatin për deputet për zonën zgjedhore Qarkun Tiranë nuk është në përputhje me pikën 4 pasi është tejkalluar nr i kërkuar i kandidatëve. Gjithashtu nuk është në përputhje me pikën 6, të nenit 67 për kriterin e gjinisë. Kërkesa për regjistrim të listës shumemërore të kandidatit për deputet për zonën zgjedhore Qarku Tiranë është e pa plotësuar në nr.19 të saj. Nuk

Zbardhi materialin e inçizuar

Silvi Sino



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021**

korespondon nr i listës shumemërore të dokumentacionit të kandidimit për kandidatin me nr.36 për zonën zgjedhore Qarku Tiranë. Në formularin e deklaramit të kandidatit për deputet me nr. 22 të Qarkut Tiranë rubrika a, rezulton e pa plotësuar pasi numgon karta e ID. Gjithashtu mungon dokumentacioni për kandidatët për deputet me nr.9, të listës shumemërore. Mungon dokumentacioni për kandidatin për deputet nr.10, Qarku Durrës. Kandidati për deputet nr.12, Qarku Durrës nuk ka plotësuar rubrikën a, dhe pikën 8 të formularit të dekriminalizimit. Rezulton e pa plotësuar dokumentacioni i kandidatit me nr.3, Qarku Gjirokastrë, formulari model 05, kandidati nr.6, Qarku Lezhë formulari model 05. Mungon dokumentacioni i kandidimit i kandidatit nr.18, Qarku Fier. Dokumentacioni i njërit prej kandidatëve Qarku Fier nuk rezulton në asnjërën prej listave. Rezulton e pa plotësuar pika 4, 5 e seksionit 2 të formularit të deklaramit për kandidatin për deputet nr 5, Qarku Fier. Rezulton e pa plotësuar pika 8 e formularit të deklaramit të kandidatit për deputet me nr.8, Qarku Shkodër. Gjithashtu rezulton e pa plotësuar pika 4 e formularit të deklaramit të kandidatit për deputet nr.1, Qarku Elbasan. Në formularin e deklaramit për deputet nr.11, Qarku Elbasan rezulton e pa plotësuar pika 8 dhe nuk ka të dhëna specifitime në këtë formular. Në këto kushte i kërkojë KQZ-së të kthejë për plotësim dokumentacionin e kandidimit për regjistrimin e mangësive të konstatuara nga subjekti politik Partia Bindja Demokratike. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, falemindert!

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit. I jap fjalën përfaqësuesit të Partisë Bindja Demokratike.

Z. F. Topollaj, përfaqësues i Partisë Bindja Demokratike: Faleminderit, jam dakord me pjesën dërmuese të gjetjeve, pjesa më e madhe e tyre janë mos plotësime

**Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

dhe gjetje të një rubrike ose ndonjë njohje në formularin e deklarimit. Kam një çështje për znj. Mardena Kelmendi që mban nr.22 në listën shumemërore të Partisë Bindja Demokratike për Qarkun e Tiranës. Thotë që vendbanimi është i pa plotësuar dhe mungon nr ID. Zonja është shtetase Shqiptare me residencë në Itali dhe nuk ka një pasaportë të viteve të fundit. Unë kam vënë mjetin e saj të identifikimit Shqiptar të vjetër të skaduar por ajo është shtetase Shqiptare që gëzon njësojë si të gjithë shtetasit e tjerë të drejtat themelore përfshirë dhe të drejtën për të kandiduar. Unë kam shënuar në formularin e saj numrin e pasaportës së vjetër që ajo zotëronte, por momentalisht nuk gëzon një të tillë prandaj nuk ka dhe një nr ID, ndoshta duan diçka të unifikuar dhe nuk është njohur nga ana e Administratës.


Z. I. Celibashi: Kuptova. Zonja në fjalë nuk ka një dokument biometrik të fundit të shtetit Shqiptar?

Z. F. Topollaj, përfaqësues i Partisë Bindja Demokratike: Jo, nuk ka sepse ka dhe letrat Italiane dhe nuk e kishte të nevojshme pasi është dhe nënshtetase Italiane njëkohësisht. Shteti Italian e lejon dy nënshtetësinë. Por është shtetase Shqiptare dhe e theksojë këtë.

Z. I. Celibashi: Dakord. Për gjetjet e tjera keni paqartësi?

Z. F. Topollaj, përfaqësues i Partisë Bindja Demokratike: Jo, në aspektin logjistik ne do e tërheqim të gjithë dokumentacionin pasi janë lapsuse dhe do e sjellim brenda afatit.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

Z. I. Celibashi: Dakort, ajo e ka dokumentacioni e vjetër dhe është regjistruar, ka nr dokumenti. Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe 2, neni 67, 72 dhe 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe udhëzimi nr 1 datë 23.12.2020 “ Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, vendos:

1.Kthimin për korrigjim sipas gjetjeve të renditura në këtë akt, përjashtuar atë të zonjës siç thamë.

2.Dokumentacioni të dorëzohet brenda datës 16.03.2021.


3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e KQZ-së;

4.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Do t’a merrni dhe të zbardhur dhe përjashtohet pika që ju sollët për diskutim, faleminderit.

Vendimi nr.129

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

**10.03.2021
Ora 18:12**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Mbi verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të kandidimit të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :


- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, O. Peto, M. Koja, E. Allushi**
- **Parti Politike:** **Koalicioni ABEOK, BK, PSD, PD, PS, PBD**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me shqyrtimin e kësaj pike për të shqyrtuar rendin e ditës.

Z. Y. Merkaj: Partia Socialiste e Shqipërisë është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Në bazë të nenit 67 dhe 71 të Kodit Zgjedhor ka paraqitur kërkesën pranë KQZ-së për miratimin e listave shumemërore. Referuar nenit 73 të Kodit Zgjedhor KQZ ka verifikuar listën shumemërore të kandidatëve për deputet të paraqitur nga Partia Socialiste dhe ka konstatuar mangësi në dokumentacion si më poshtë :

Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore për kandidatin për deputet për zonën zgjedhore Qarkun Elbasan nuk është në përputhje me artikullin 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor për sa i përket kriterit gjinor të përcaktuar në këtë nen. Gjithashtu ka dhe disa deklarata të kandidatit për deputet të Qarkut Durrës, Korçë, Fier, të cilat në

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021**

formularët e deklarimit në disa rubrika figurojnë të pa plotësuar. Në formularin e deklarimit të numrit rendor të listës për Qarkun e Fierit nr.4 te rubrika “a” doli e pa plotësuar atësia dhe mëmësia si dhe karta e ID. Gjithashtu në disa formularë deklarimi në Qarkun Fier, Lezhë dhe Vlorë ka parregullsi, në disa pika mungon firma ose nuk është plotësuar çdo rubrikë e këtij formulari. Në këto kushte i kërkojë KQZ-së të kthejë për plotësim dokumentacionin e kandidimit për regjistrimin e mangësive të konstatuara nga subjekti politik Partia Socialiste. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës. Falemindert!

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit. I jap fjalën përfaqësuesit të Partisë Socialiste zoti Salianji.

Z. E. Salianji, përfaqësues i Partisë Socialiste: Faleminderit, parimisht jam dakord me gjetjet e bëra nga KQZ-ja për sa i përket mangësive në njërin prej listave të kandidatëve ku nuk është plotësuar gjinia si dhe problemet teknike për sa i përket plotësimit të formularit që ka të bëjë me mos firmosjen ose mos vendosjen e nr. të ID në ndonjë fletë të formularit të dekriminalizimit. Unë do propozoja që nga projektvendimi përderisa kërkesat janë të vecanta për cdo qark, dispozitivi të jetë kthim për korrigjim të listës Qarku Elbasan siç është dhe fakti, aty ku është gjetja ose të shënoni në dispozitiv gjithë gjetjet por për kthim të shënoni vetëm Qarku Elbasan për shkak të difektit në listë siç është gjinia, mund të rregullohemi dhe këtu pasi e kam tagrin. Për shkak të nxitimit në kompjuter është shkruar ashtu por përderisa keni lënë afat do e sjellim dokumentacionin e korrigjuar. Por për dispozitivin dua që të shprehet më qartë.

**Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit, për sa i përket dispozitivit të vendimit bazuar dhe në përcaktimet e Kodit Zgjedhor. Kodi Zgjedhor përcakton se dokumentacioni kthehet i gjithi dhe plotësohet për ato të cilat kanë nevojë për t'u plotësuar. Mendojë që të risillni dokumentacionin për qarqet e tjera dhe të korrigjoni aty ku ka mangësi pasi është në çmimin dhe vlerësimin tuaj për të korrigjuar në tërësi. Dokumentacioni ka një limit është unik i gjithi për gjithë territorin e Republikës edhe pse është i ndarë sipas qarqeve. Jam dakord me rekomandimin dhe propozimin tuaj që të listohet natyra e korrigjimit që duhet të bëhet nga ana juaj në lidhje me dokumentacionin zgjedhor, të kandidimit të depozituar.

Z. E. Saliqani, përfaqësues i Partisë Socialiste: Meqenëse është një vendim publik, pra sipas gjetjeve dhe gjetjet të listohen në dispozitiv.


Z. I. Celibashi: Jeni dakord, keni diskutime? Nuk keni. Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronj "n" dhe 2, neni 67, 72 dhe 73 pika 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe Udhëzimi nr.1 datë 23.12.2020 "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit" vendos:

- 1.Kthimin për korrigjim sipas gjetjeve të renditura në këtë akt, këtë dokumentacion të listës shumëmeore të kandidatëve për deputet të Partisë Socialiste të Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
- 2.Dokumentacioni të dorëzohet brenda datës 16.03.2021.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e KQZ-së.
- 4.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Pra shpallja publike do të bëhet sipas gjetjeve, faleminderit.

Vendimi nr.130

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

**10.03.2021
Ora 18.35**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Mbi verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të kandidimit të subjektit zgjedhor, koalicioni Aleanca për Ndryshim PD, PR, PDIU, PAA, PBDNJ, PDK, LZHK, PLL, FRD, BLD, PBKD, PBD, PKD, PD-AN” për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto, E.Jorgaqi, E.Allushi**
- **Parti Politike: BK, PSD, PD, PS, PBD, ABEOK**

Z.I.Celibashi: Mirë, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës! Vlerësimi i dokumentacionit të listës shumëemërore të kandidatëve për deputetë të koalicionit, Aleanca për Ndryshim, Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim.

Z.Y.Merkaj: Koalicioni, Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25 prill 2021. Bazuar në nenin 67, 72, të Kodit Zgjedhor, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dokumentacionin për miratimin e listave shumëemërore për 12 zona zgjedhore. Referuar nenit 73, të Kodit Zgjedhor, është bërë verifikimi i listave shumëemërore për kandidatë për deputetë të koalicionit. Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim, dhe në përfundim procesit të verifikimit, kanë konstatuar mangësi dhe mospërputhje, mospërmbushje dokumentacioni, si më

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

poshtë: për qarkun Tiranë, qarkun Elbasan, Berat, Kukës, Gjirokastrë, Dibër, Shkodër, Durrës, Fier, Vlorë dhe Korçë, janë konstatuar, disa shuma, nuk janë në përputhje me pikën 4, të nenin 67, të Kodit Zgjedhor, pasi është tejkalluar numri i kërkuar i kandidatëve në listën shumëemërore të kandidatëve, si dhe vërehen mospërbushje të kërkesave ligjore për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas nenit 138, të vitit 2015. Për qarkun Tiranë, dhe qarkun Korçë, përveç mosplotësimit të pikës 4, të nenit 67, nuk është respektuar dhe kuota gjinore sipas pikës 6, të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte, i kërkojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të kthejë për plotësim të dokumentacionit të kandidimit të subjektit zgjedhor, koalicionin, Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim, dhe miratim, si dhe dokumentacionin përkatës. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Po, faleminderit! Fjalën ia japim përfaqësuesit të Partisë Demokratike dhe rrjedhimisht dhe të koalicionit Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim.

Përfaqësues i Partisë Demokratike: Dakord, i nderuar! Dokumentacioni do të përmbushet brenda kohës së caktuar, me gjithë mangësitë e vërejtura.

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Nuk keni ndonjë pretendim tjetër?

Përfaqësues i Partisë Demokratike: Jo

Z.I.Celibashi: Në rregull! Mirë, atëherë bazuar në nenin 19, pika 1 dhe vijues të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, të udhëzimit nr.1, datë 23.12.2020,

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



***Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021***

vendos: Kthimin për korrigjim sipas zgjedhjeve të renditura më sipër të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumëemërore të kandidatëve për deputetë të koalicionit Partia Demokratike, Aleanca për Ndryshim, me shkronjat nistore, PD, PR, PDIU, PAA, PBDNJ, PDK, LZHK, PLL, FRD, BLD, PBKD, PBD, PKD dhe PD-AN, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021. Dokumentacioni i korrigjuar të depozitohet, brenda datës 16.03.2021. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim brenda tre ditëve, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve. Faleminderit!

Vendimi nr.131

***Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA***



**10.03.2021
Ora 18.38**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Mbi verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të kandidimit të subjektit zgjedhor, koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët” për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021 ”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi

• **Parti Politike: ABEOK, BK, PSD, PD, PS, PBD**

Z.I.Celibashi: Po, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Koalicioni Aleanca për Bashkimin Popullor – Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet, për Kuvendin e Shqipërisë, datës 25 prill 2021. Në bazë të nenin 67, 72 të Kodit Zgjedhor, kanë paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dokumentacionin për miratimin e listave shumëemërore. Në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, është bërë verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky koalicion, dhe në përfundim të procesit të verifikimit paraprak, janë konstatuar mangësi, dhe mospërputhje të dokumentacionit si më poshtë: Kërkesa për regjistrimin e listës shumëemërore të kandidatëve për deputetë, për zonën zgjedhore, qarku Berat, qarku Elbasan, qarku Gjirokastrë, qarku Fier, qarku Kukës, dhe qarku Tiranë, nuk janë në përputhje me pikën 4, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor,

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*


pasi është tejkaluar numri i kërkuar i kandidatëve në listën shumëemërore të kandidatëve. Gjithashtu për qarkun në Tiranë, nuk është plotësuar dhe kriteri gjinor i përcaktuar në pikën 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu rezultojnë që kandidatët për deputet, në qarqet, Fier, Berat, Dibër, Durrës, Vlorë, rezultojnë që formularët e deklarimit të kandidatëve, shumë rubrika rezultojnë të paplotësuara, dhe nuk kanë plotësuar dhe numrin e ID-së. Në këto kushte, duke qenë se, pothuajse në të gjitha qarqet, formularët e kandidimit kanë rezultuar me probleme, dhe disa formularë nuk janë dorëzuar fare, i kërkojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të kthejë për plotësim të dokumentacionit të kandidimit për subjekt zgjedhor, koalicionin Aleanca për Bashkim Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës të këtij koalicioni. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesi i koalicionit?

Z.Sh.Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Po, i nderuar zoti kryetar! Pasi u njohëm me relacionin, dhe me projektvendimin e dhënë, të gjitha këto që janë sigluar këtu do t'i plotësoj, sipas afatit ligjor. Por, doja të sqaroja diçka që, ka deklaruar të plotësuar "jo", në pikën 2, që thotë këtu, por ka të dhëna specifike. Kë mund të marrim? Sepse gjersa ajo është "jo", që në fillim, nuk mund t'i hysh atyre në përmbajtje, se çfarë mund të jenë shkruar, mendoj. Apo ta plotësojmë që nga fillimi komplet atë. Luan Jakimi, qarku i Dibrës, rezulton, se në pikën 8, ka deklaruar të plotësuar "jo", por ka specifikuar, ka të dhëna specifike, që duhet të bëhet nga e para.

Z.I.Celibashi: Ka dhënë sqarime, e ka plotësuar "jo", dhe ka dhënë sqarime?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

Z.Sh.Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Po!

Znj.M.Koja: Rubrika 8, ka të bëjë me vetëdeklarimin, nëse ka qëndruar jashtë Republikës së Shqipërisë. Në raste të tilla, nëse deklaron, “po”, zgjedh opsionin, “po”, atëherë, plotëson rubrikat poshtë. Nëse ti e zgjedh, “jo”, por ke plotësuar rubrikat që e pasojnë, atëherë ka një mospërputhshmëri. Duhet të përputhet deklarata, “po”, ose, “jo”, me atë vijuese.

Z.I.Celibashi: Pra, nëse ke shënuar që pyetjes që: -a ke jetuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë? Nëse ke shënuar, “jo”, dhe ndërkohë më poshtë, të dhënat tregojnë që ti ke qenë, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ka një kontradiktë, kjo duhet rregulluar. Kjo është ideja, apo jo?

Znj.M.Koja: Po!

Z.I.Celibashi: Dakord! Mirë, atëherë, meqënëse nuk kemi diskutime të tjera për këtë pikë. Bazuar në nenin 19, pika 1, dhe vijues të Kodit Zgjedhor, si dhe udhëzimi nr.1, datë 23.12.2020, vendos: kthimin për korrigjim sipas zgjedhjeve të renditura më sipër të dokumentacionit për regjistrim të listës se shumëemërore të kandidatëve për deputet të koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shqipërisë dhe Konservatorët, me shkronjë listore, ABEOK, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Dokumentacioni i korrigjuar të depozitohet brenda datës 16.03.2021. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kundër këtij vendimi mund të bëjnë ankim brenda tri ditësh në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve,

Vendimi nr.132

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

**10.03.2021
Ora 18.43**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për kthimin për korrigjim të dokumentacionit të listës shumëemërore të kandidatëve për deputet, të depozituar nga Partia SocialDemokrate, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ:** **Y.Merkaj, O.Peto, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PBK, PSD, PD, PS, PBD, ABEOK**

Z.I.Celibashi: Po, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Partia SocialDemokrate është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021. Në bazë të neneve 67, 70 të Kodit Zgjedhor ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën për miratimin e listave shumëemërore për 12 zonat zgjedhore. Referuar nenit 73, të Kodit Zgjedhor, është bërë verifikimi i listave shumëemërore të kandidatëve për deputetë, të Partisë Social Demokrate, dhe në përfundim të procesit të verifikimit paraprak, u konstatuan mangësi dhe mospërmbushje të dokumentacionit, si më poshtë: Kërkesa për listimin e listave shumëemërore të kandidatëve për deputetë të zonës zgjedhore të qarkut Berat, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, duke mos respektuar numrin e kërkuar në listën shumëemërore.

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

Kërkesa për regjistrimin e listave shumëemërore të kandidatëve për deputetë, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, nuk është në përputhje me pikën 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, pasi nuk është respektuar kuota e gjinisë. Po kështu, dhe në qarkun e Elbasanit, nuk është në përputhje me pikën 4, neni 67, është tejkualuar numri i kërkuar në listë shumëemërore dhe nuk është respektuar kuota gjinore. Në qarkun Dibër, nuk është respektuar numri i kërkuar për kandidatë për deputetë në listën shumëemërore. Në qarkun Lezhë, nuk është respektuar numri i kandidatëve si dhe kuota gjinore. Gjithashtu, dhe në qarkun Durrës, nuk është respektuar kuota gjinore, siç është parashikuar sipas pikës 6, dhe nenit 67. Në qarkun Korçë, është tejkualuar numri i kërkuar në listën shumëemërore. Po kështu dhe në qarkun Dibër, është tejkualuar numri i kërkuar me një kandidat, si dhe nuk është plotësuar formulari model 05, për gjithë kandidatët. Në listën shumëemërore të qarkut Shkodër, mungojnë ID-të e kandidatëve për numrin rendor 4, 6, 8 dhe 9. Kërkesa për regjistrimin e listave shumëemërore të kandidatëve për deputetë për zonat zgjedhore, qarku Gjirokastrë, nuk është në përputhje me pikën 4, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, duke mos plotësuar numrin e kërkuar të kandidatëve në listë shumëemërore. Gjithashtu, në lidhje me formularët e vetëdeklarimit të dorëzuar, për zbatim të kërkesave të ligjit 148, të vitit 2015, vërehen, se ka parregullsi në dokumentacionin e dorëzuar, pothuajse në të gjitha qarqet. Në këto kushte, i kërkojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të kthejë për plotësim dhe korrigjim, dokumentacionin e paraqitur nga Partia Social Demokrate. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin përkatës. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Po, faleminderit! Përfaqësuesi i partisë Social Demokrate.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

Z.R.Preçi, përfaqësues i PSD-së: Po, zoti kryetar, ne u njohëm me projektvendimin, Jemi dakord me të gjitha gjërat, vërejtjet që janë bërë me dokumentacionin e partisë sonë. Do të shtoj diçka që, tani 10 minuta pa filluar mbledhja, kemi plotësuar pjesën dërrmuese të këtyre. Mund t'iu komunikojmë ndoshta dhe këtu. Kemi plotësuar dhe këtë, qarkun Tiranë, çështjen gjinore. Dhe plotësimin e dokumentacionit që është në fund atje, kur thotë, në Tiranë, janë ca emra, tek pika 17, i kemi rregulluar. Për qarkun Dibër, vërejtja që, me një kandidat, e kemi plotësuar.

Z.I.Celibashi: Më fal, jo, ska problem, por, se ne nuk jemi në dijeni të kësaj. Deri në momentin që keni përgatitur këto gjetjet, qëndrojnë.

Z.R.Preçi, përfaqësues i PSD-së: Kemi nga 17 çështje që janë, një nga një, i kemi ndarë tani, çfarë kemi plotësuar, dhe pjesën tjetër...

Z.I.Celibashi: Por, prap ngelen pa plotësuar.

Z.R.Preçi, përfaqësues i PSD-së: Do ta rregullojmë. Nuk e di, një pyetje kam kryetar. Mund të marrim dokumentacionin, në një, që ta plotësojmë sipas kësaj, apo duhet..?

Z.I.Celibashi: Do të bëhet korrigjimi i dokumentacionit. Ne e kthejmë të gjithë dokumentacionin, dhe ju do bëni korrigjimin të atyre gjetjeve tona. Ju thoni, një pjesë e kemi bërë, dakord! Nuk ka asnjë lloj problemi, por në afatin që do t'iu caktojmë ne, duhet ta risillni të plotësuar.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

Z.R.Preçi, përfaqësues i PSD-së: Po, sigurisht. Por duhet për shembull, qarku Lezhë që kam diçka mangët ose në Elbasan, se konkretisht aty nuk kemi plotësuar, duhet të marrim krejt dosjen?

Z.I.Celibashi: I gjithë dokumentacioni do të plotësohet.

Z.Y.Merkaj: Më falni zoti Komisioner! Do të marrin, kopje të dokumentacionit, jo dokumentacionin origjinal.


Z.I.Celibashi: Po, po, kopje.

Z.R.Preçi, përfaqësues i PSD-së: Dakord! Në datën 15 jemi gati!

Z.I.Celibashi: Mirë, atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1, dhe vijues të Kodit Zgjedhor, si dhe udhëzimit nr.1, datë 23.12.2020, për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin në listat e kandidatëve, miratim me modelet e kandidimit, vendos: Kthimin për korrigjim sipas gjetjeve të renditura më sipër të dokumentacionit, për regjistrimin e listës shumëëmërore të kandidate për deputetë të Partisë Social Demokrate për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021. Dokumentacioni i korrigjuar të depozitohet brenda datës 16.03.2021. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, dhe publikohet në faqen zyrtare, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim vetem brenda tri ditëve, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve. Faleminderit!

Vendimi nr.133

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

**10.03.2021
Ora 18.48**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të shoqatës ”Qendra për transparencë” për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto, E.Allushi**
- **Parti Politike: BK, PSD, PD, PS, PBD, ABEOK**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Shoqata “Qendra për Transparencë”, i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 21 vëzhguesve afatgjatë, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Shoqata “Qendra për Transparencë”, është një organizatë që punon në fushën e demokracisë, dhe të drejtave të njeriut, dhe synon të nxisë dhe të forcojë transparencën në vendimmarrjen publike. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstaton se, është në përputhje me nenin 6, të Kodit Zgjedhor, si dhe me pikën 4, udhëzimi nr.2, të vitit 2021, për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare, shqiptare, dhe të huaja, organizata ndërkombëtare, përfaqësuesit e shteteve të huaja, mediat dhe subjektet zgjedhore. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës. Faleminderit!

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

Z.I.Celibashi: Mirë, atëherë, meqenëse dokumentacioni i Shoqatës “Qendra për Transparencë”, në lidhje me kërkesën për t’u regjistruar për akreditimin e 21 vëzhguesve afatgjatë, është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, vendos të miratoj kërkesën e Shoqatës “Qendra për Transparencë”, për akreditimin e 21 vëzhguesve afatgjatë, për vëzhgimin e procesit zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr. 134

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

**10.03.2021
Ora 18.49**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë, të organizatës “Rrjeti i fuqizimit të gruas në Shqipëri” për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **BK, PSD, PD, PS, PBD, ABEOK**

Z.Y.Merkaj: Organizata “Rrjeti i Fuqizimit të gruas në Shqipëri”, ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën për akredimin e 10 vëzhguesve afatgjatë, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Organizata “Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri”, është një organizatë që punon në fushën e të drejtave të njeriut, në mënyrë të veçantë, në fushën e të drejtave të grave dhe vajzave. Qëllimi kryesor i këtij rrjeti, është fuqizimi social, ekonomik, kulturor dhe politik i gruas në Shqipëri, Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatoam se, është në përputhje me nenin 6, të Kodit Zgjedhor, dhe udhëzimit nr.2, të vitit 2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe listën e vëzhguesve afatgjatë. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Atëherë, meqenëse, kërkesa dhe dokumentacioni bashkëlidhur kërkesës së organizatës “Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri”, për

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

të akredituar 10 vëzhgues afatgjatë, është në përputhje me parashikimin e Kodit Zgjedhor, vendos të miratoj kërkesën e organizatës “Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri” për akreditimin e 10 vëzhguesve afatgjatë, për vëzhgimin e procesit zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr. 135

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



10.03.2021
Ora 18.50

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e gazetarëve të qendrës “Faktoje” për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto, E.Allushi**


• **Parti Politike: BK, PSD, PD, PS, PBD, ABEOK**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër.

Z.Y.Merkaj: Qendra “Faktoje”, i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën e dokumentacionit për akreditimin e 5 gazetarëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Qendra “Faktoje”, ka si objekt zhvillimi të gazetarisë investigative, nxitjen e debatit publik mbi reformat politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të orientuara drejt integritetit europian. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, konstatohet se është në përputhje me nenin 6, të Kodit Zgjedhor, si dhe udhëzimi nr.2, të vitit 2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Bashkëlidhur kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën e gazetarëve, bashkëlidhur projektvendimit. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Atëherë, meqenëse kërkesa dhe dokumentacioni bashkëlidhur kërkesës i qendrës “Faktoje”, për akreditimin e 5 gazetarëve, për

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



***Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021***

vëzhgimin e procesit zgjedhor, është në përputhje me parashikimet e Kodit dhe udhëzimit përkatës, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vendos të miratoj kërkesën e Qendrës “Faktoje”, për akreditimin e 5 gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021, sipas listës bashkëlidhur, listës së përcaktuar në lidhjen 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendim nr.136

***Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

**10.03.2021
Ora 18.51**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për miratimin e gazetarëve të televizionit “Fax Media News”
për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021”.**

PJESËMARRJA :


- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, O. Peto, E. Allushi**
- **Parti Politike: BK, PSD, PD, PS, PBD, ABEOK**

Z.I. Celibashi: Pikë tjetër në rendin e ditës?

Z.Y. Merkaj: Po, televizioni “Fax Media News”, ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën për akreditimin e 52 gazetarëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Televizioni “Fax Media News”, është kanal televiziv informues dhe i shtrirë në të gjithë territorin e vendit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se është në përputhje me nenin 6, të Kodit Zgjedhor, si dhe udhëzimit nr.2, të vitit 2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe listën e 52 gazetarëve, bashkëlidhur projektvendimit. Faleminderit!

Z.I. Celibashi: Mirë, atëherë meqenëse kërkesa dhe dokumentacioni bashkëlidhur kërkesës i televizionit “Fax Media News”, për akreditimin e disa gazetarëve është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, dhe udhëzimi përkatës i

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.03.2021*

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vendos të miratoj kërkesën e televizionit “Fax Media News” për akreditimin e 52 gazetarëve, për vëzhgimin e procesit zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kjo ishte pika e fundit e rendit të ditës. Mirë, seanca mbyllet, faleminderit!

Vendimi nr.137

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*

